



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**BASHKIA SHIJAK
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr ____ Prot

Data __,__. 2023

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“BLERJE KOMPJUTERA DHE PRINTERA PËR NEVOJA TË BASHKISË SHIJAK
”**,

TIPI I KONTRATËS- MALL

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

30213300-8

30232110-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, njësia e prokurimit në Bashknë Shijak ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ..3.;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojces 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP si dhe në nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Këto kërkesa vendosen për të provuar se operatori ekonomik vepron konform dispozitave të legjisllacionit në fuqi.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP.

2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore , në përputhje me përcaktimet e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar , në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së për vitin 2022 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2023 Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Certifikatë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”/ ekuivalent

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin provues: Certifikatat origjinale ose kopje e noterizuar, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter i përcaktuar është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” ku percaktohet se: *1. Autoriteti/entikontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.* Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

Përmbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020 ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.* Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimimi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e vlerës se perlllogaritur të kontratës. Për të provuar aftësinë /përshtatshmërinë profesionale të OE, AK duke analizuar rast pas rasti bazuar në parimin e proporcionalitetit në objektin e kontratës që do të prokurohet, ka gjykuar te arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet profesionale të OE. Në këtë mënyrë AK krjon bindjen e përgjithshme në aftësinë profesionale të OE duke u bazuar në përvojat e mëparshme të tij realizuar në sektorin privat/publik për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i permbushur nese ne dy bilance te njepasnjeshme nuk ka raporte negative ndermjet aktivitet dhe pasivitet.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv paraqesin vërtetësi dhe besueshmëri në pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne të cilin gjejmë të percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ne të cilin është e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Ofertuesi i kualifikuar I pari duhet të paraqesë Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore, ku të specifikohet Nr. i punonjësve për secilin muaj (formulari E-SIG02/a) për periudhën shtator 2023 dhe tetor 2023 .

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015** (ose e përditësuar) (ose ekuivalente) në fushën e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit;

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin provues: Certifikatat origjinale ose kopje e noterizuar, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 36 dhe nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikën 7/c, të nenit 40, si dhe nenin 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Njoftimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 prot., datë 09.04.2021 si dhe ligjin nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikatë duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontratë. Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e realizimit të objektit të prokurimit, në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve, sigurinë e informacionit gjatë zhvillimit, gjatë instalimit e konfigurimit dhe në lidhje me menaxhimin, kuptimin dhe përkthimin e proceseve të biznesit në procese IT.

2.3.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, **skedën teknike** për artikujt objekt prokurimi si dhe platformen e menaxhimit, sipas tabelës së mëposhtme:

A	B	C	D
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese	Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve
1	KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"		
2	KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"		
3	PRINTER B&Ë Advanced		
4	FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4		

Konkretisht në kolonën **D**, të skedës teknike, operatorët ekonomikë duhet të japin një përshkrim të plotë të karakteristikave teknike për artikujt e specifikuar, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara. (Numrat rendor i referohen numrave të artikujve sipas tabelës në shtojcën 6 ”Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues, me anë të kësaj skede teknike, të garantojnë Autoritetin Kontraktor se artikujt e ofruar do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me atë të deklaruar në ofertë dhe që përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike.

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga *prodhuesit* ose nga *distributorët e autorizuar nga prodhuesit*, për tregtimin e artikujve objekt prokurimi (sipas tabelës së përcaktuar në pikën 2.3.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur : për të rritur sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues, për shkak të natyrës së veçantë të artikujve objekt prokurimi dhe për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuar nga ofertuesit.

Kriteri është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie për artikujt e kërkuar dhe në rast shpallje fitues duhet ti lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garancie tw artikujve tw kwrkuar per dy vite.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

1. Specifikimet teknike :

NR	Pershkrimi i Mallrave	Njesia	Sasia
1	KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23”	cope	15
2	KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24”	cope	10
3	PRINTER B&Ë Advanced	cope	1

1. KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	11,000 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	16 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	512 GB SSD
“Graphics”:	Integrated HD Graphics
Ekrani “Display”:	23" Min. FHD (1920x1080) LED Backlight, Anti-Glare
"Ëeb Camera":	Min. FHD Camera
“Speakers”:	Internal Stereo Speakers
Ushqimi “Poëer Supply”:	220 V AC, 50 Hz
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (5) USB nga të cilat min. (2) USB 3.0; (1) RJ-45; (1) DP/HDMI Min. (1/1)Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack; (1) Integrated Mic.;
Rrjeti “Netëorking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Ëireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Ëindoës 10 64-bit Professional
Te perfshire	License Virtuale per cdo Kompjuter të licencuar për pajisje kompjuter me keto specifikime si me poshte: <ul style="list-style-type: none"> • Të mundësojë instalim “nga zero” të kompjuterave. • Të mundësojë instalim softëari të ri apo upgrade të kompjuterave. • Të mundësojë përdorues të rinj të kompjuterave. • Të mundësojë instalimin nga distanca për platforma Ëindoës. Të mundësojë menaxhimin njëkohësisht të sistemeve të ndryshëm
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QËERTY
“Pointing Device”:	Standart Optical Mouse
Siguria “Security”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Poëer Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition

Të tjera:	Energy Star
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	3 Vjet

2. KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	15,000 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	16 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	512 GB SSD
“Graphics”:	Integrated HD Graphics
Ekrani “Display”:	24" Min. FHD (1920x1080) LED Backlight, Anti-Glare
“Ëeb Camera”:	Min. FHD Camera
“Speakers”:	Internal Stereo Speakers
Ushqimi “Poëer Supply”:	220 V AC, 50 Hz
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (5) USB nga të cilat min. (2) USB 3.0; (1) RJ-45; (1) DP/HDMI Min. (1/1)Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack; (1) Integrated Mic.;
Rrjeti “Netëorking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Ëireless 802.11ac (Kompatabël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:	OEM Ëindoës 10 64-bit Professional
Te perfshire	<p>License Virtuale per cdo Kompjuter të licencuar për pajisje kompjuter me keto specifikime si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mundësojë instalim “nga zero” të kompjuterave. • Të mundësojë instalim softëari të ri apo upgrade të kompjuterave. • Të mundësojë përdorues të rinj të kompjuterave. • Të mundësojë instalimin nga distanca për platforma Ëindoës. <p>Të mundësojë menaxhimin njëkohësisht të sistemeve të ndryshëm</p>
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QËERTY
“Pointing Device”:	Standart Optical Mouse
Siguria “Security”:	Embedded Security TPM 2.0

AKSESORËT	
Kabëll “Poëer Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
Të tjera:	Energy Star
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	3 Vjet

3. PRINTER B&Ë Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Shpejtësia e Printimit “ Print Speed” A4:	≥ 45 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	60 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser
Rezolucioni i Printimit Minimal “Print Quality”:	1200x1200 dpi
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	500 Fletë
Pesha Specifike e Letrës “Media Sizes”:	60-120 g/m ²
Formati i Letrës “Media format”:	A4/A5/Envelope
Aftësia e Printimit Duplex:	Po
Memorja “Memory”:	≥ 256 MB
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0
“Ethernet”:	Po
AKSESORËT	
Kabëll “Poëer Cord”:	Po, European
Softëare/Drivers CD :	Po
Kabëll USB:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	2 Vjet
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

4. FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer, Scanner
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4 B&Ë”:	≥ 20 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	≥ 30 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser Color/B&Ë
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25% - 400%
Vendosja e Letrës “Document Feeder”:	ADF
Sirtaret per Letrën “Paper Trays”:	min 1
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min.”:	150 Fletë (jo Bypass)

Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min. Standard”:	100 Fletë
Kopjim/Printim në të dy Faqet “Duplex Copying/Print.”:	Nuk Specifikohet
Formati i Letrës “Media Sizes”:	A4
Memorja “Memory”:	≥ 256 MB
“Hard Disk”:	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed”:	Nuk Specifikohet
Rezolucioni i Skanimit “Scan Resolution”:	600 dpi
Ushqimi "Poëer Supply":	220 V AC, 50 Hz
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0
“Ethernet”:	Po
AKSESORËT	
Kabëll “Poëer Cord”:	Po, European
Softëare/Drivers CD:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	1 Vit, 90 000 Kopje *
* Kush të arrihet më parë	
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

Afati i lëvrimit të mallit (ku të përfshihet instalimi dhe konfigurimi) 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Specifikimet teknike janë hartuar referuar nevojave të AK dhe pjesërisht standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Afati i lëvrimit të mallit (ku të përfshihet instalimi dhe konfigurimi) 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i lëvrimit janë ne përputhje me piken 3, germa b te nenit 15 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

NJËSIA E PËRLLOGARITJES DHE HARTIMIT TË SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Albiona Mehmeti

Ernest Domi

Antonio Bregu

